



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të
Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus + në University of Chieti, Itali**

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Chieti, (Università degli Studi "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara), Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Kohëzgjatja e bursave për studentët: Semestri i II i vitit akademik 2022 - 2023;

Numri total i studentëve: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke evërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Chieti lëndët të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni më poshtë:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies_student.pdf \(upt.al\)](#)

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më
22 dhjetor 2022**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:
rkodra@upt.al dhe abego@upt.al